



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019) dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2019, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 2997-0, me sipërfaqe prej 4 m², e evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. P-71914052-02997-0, Zona kadastrale Mramor - Prishtinë, pasuri shoqërore, Kuvendi Komunal Prishtinë.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është vendosja e trafostacionit elektro-energetik TSSH, Butovc, 1-100 KVA.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është për 15 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.
- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij Vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
- kërkesa,
 - skica grafike,
 - certifikata e njësisë kadastrale dhe
 - destinimi për pjesën kadastrale, nr. P-71914052-02997-0.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0101081/19, më 03.05.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

